Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 11.05.2022*	*Data e dorëzimit të raportit 20.05.2022*	Nr. i lëndës: *127/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 05.05.2022, OE **"Alpha Private Security"Shpk** – Prishtinë,ka parashtruar ankesë me nr: 127/22, kundër njoftimit për kontratë,lidhur me aktivitetin e prokurimit, " Sigurimi fizik i objekteve të KEK-ut",me nr.të prokurimit: 22-2883-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KEK".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:Kontratë Publike Kornizë, **Shërbime**,vlera e parashikuar e kontratës: **3,000,000.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

- Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore
- Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
- Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur
- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 27 Dosja e Tenderit
- Neni 28 Specifikimet teknike
- Neni 40 Njoftimi i Kontratës
- Neni 44 Rregullat e Përgjithshme mbi Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje
- Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratësNeni 53 Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit

Pasi që AK nuk ka respekuar nenin 108A në shqyrtim këtë e themi sepse pa ndonjë argument bindës vetëm ka refuzuar kërkesen tonë neve jemi të detyraur ta ri-shkruajm kompet ankesën pasi që nuk këmi marrë vendim shqyrtues.

Pas njoftimit për kontratë neve kemi shkarkuar dosjen e tenderit dhe kemi parë kriteret për të cilat pamë se kishte shumë paqartësi përveqse kësaj juve nuk keni respektuar edhe afatet kohore të përcaktuara për pranimin e ofertave për arsye se LPP neni 44 paragrafi:

2.2. kur kontrata përkatëse nuk është kontratë publike me vlerë të madhe,jo më pakse njëzet(20) ditë.

Ndërsa ju keni lënë më pakë se 20 ditë që bie në kundërshtim me LPP-në.
Po ashtu lidhur me kërkesat tjera neve kemi dërguar pytje ku kemi kërkuar
Lidhur me kërkesen tuaj ku keni kërkuar:
Dëshmi se zyrtari ngarkuar për siguri dhe shëndet ne pune posedon Certifikatat nga MPMS për dhënien e provimit profesional nga fusha sigurisë dhe shëndetit në punë, sipas ligjit NR. 04 L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNËdhe aktevete ndërlidhura nënligjore. Te dëshmohet me kopje te certifikatës, kopje te deklaratës se trustit pensional dhe kontrate pune.

Neve këtë kërkes e kundërshtojm pasi që është e pabazë dhe ka mundësi të zëvendesohet me një kontratë duke angazhuar një kompani për mbikëqyrje për SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË?

- Në kërkesen tuaj ku keni kërkuar:

Duke marr parasysh rendësin e objekteve qe duhet te ruhen si dhe nivelin stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për autoritetin kontraktues. Paga minimale neto bazë (para aplikimit te tatimeve, kontributeve, pagesave shtese dhe lejimeve konform Ligjit të Punës ne fuqi), për roje fizike të angazhuar ne ketë kontratë duhet të jetë jo me pak se 350 € ne muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar qe te respektoj Ligjin e punës dhe Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2017 . Ne kete rast Kontraktori obligohet te paguaj shtese mbi pagën neto baze për ndërrimin e dyte dhe te trete dhe festa. Kontraktori obligohet te furnizoi edhe nje shujtë te ngrohte për çdo ndërrim.
Duke iu referuar Ligjit te punës ne fuqi dhe UA te ndërlidhura, fondi orëve për një muaj është 176 për një muaj.

Duke u bazuar në ligjin e punës cilat nga kërkesat për zbatim që dalin nga ky ligjë duhet të respektohen/ kalkulohen:
Neni 56 Paga shtesë 1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.
2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
2.1. 20 % në orë për kujdestari;
2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;
2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;
2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.
3. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë

njëratjetrën.
Cilat nga këto kërkesa duhet të respektohen ?

- Lidhur me kërkesen tuaj ku keni kërkuar që:

II.Operatori Ekonomik është i obliguar qe punëtoret e angazhuar te pajisen me Uniform unike te punës. Uniformat duhet te u përshtaten standardeve mbi sigurimin fizik te objekteve sipas Ligjit për Sherbimet Private te Sigurisë (Nr. 04/L-004) dhe sipas kërkesës se standardeve nga MPB dhe duhet te përmbajnë:

Nr.	Uniforma dimërore:	Sasia	Nr.	Uniforma verore	sasia
1	Jakne (xhaketë) trashe dimërore me emblema te shtypura te kompanisë	360	1	Këmishë verore me mëngë te shkurta me emblema te shtypura te kompanisë	360
2	Xhemper i trashe dimëror me emblema te shtypura te kompanisë	360	2	Pantallona verore	360
3	Këmishë me mëngë te gjata me emblema te shtypura te kompanisë	360	3	Kravata	360
4	Pantallona dimërore	360	4	Jakne (xhaket) verore me emblema te shtypura te kompanisë	360
5	Këpucë te punës	360	5	Këpuca te punës (verore)	360

Bazuar në ligjin për siguri private secila kompani ka përshkrimin e uniformes së saj ku merret edhe një vendim ju lusim që ta na sqaroni se mjafton që te jepet oferta sipas vendimit të Divizionit të sigurisë private në MPB.

Në përgjigjëjen tuaj keni cekur:
OE duhet te pajisin te gjithepunëtorët ne shërbim me Uniformat sipas standardeve mbi sigurimin fizik te objekteve sipas Ligjit për Sherbimet Private te Sigurisë (Nr. 04/L-004) konfrom profilit të kompanis të dorëzuar ne MPB si dhe kushteve te punes ne terren te kerkuara. Ne kete rast, ne baze te kerkesave te DT nenkuptohet se punetoret duhet te pajisen miminum me uniforme se aprovuar nga MPB si pshkepuce (verore dhe dimerore).

Ju nuk i jeni përgjigjur kërkeses tonë dhe se qka do të veprohet me OE që nuk kanë këto pjesë, si dhe me qdo do dëshmohet vlera e uniformave, qka do të ndodhë me OE-të që ofrojnë qmim apnormal të ulët a do të eliminohet etj…
Lidhur me pagat e menaxherve neve kemi pyetur:Paga në vlerë prej 500 euro në muaj a është Bruto apo Neto? Per menaxhera paga minimale e cekur eshte neto.

Kërkojm tëspecifikoni qartë se qka duhet kalkuluar në pagën neto të menaxherëve?

Neve kemi dërguar pyetje edhe për analizën finaciare ku kemi kërkuar sipas përshkrimit tuaj ju keni cekur:

OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet te përfshijë se paku:

- Pagat neto për punëtorë me te gjitha kontributet dhe tatimet,
- Pushimet vjetore, ndërrimet e natës, festat shtetërore,
- Shujte te ngrohte (me vlere referente jo me te vogël se 1.75 € për një shujte).
- Vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit ne dosje te tenderit,
- Sigurimi shëndetësor për roje, menaxher te projektit dhe menaxher te zonave me mbulim dhe përfitime minimale te obligueshme sipas ANEKSIT A me poshtë.
- Shpenzimet tjera dhe fitimin e pritur te OE nga kjo kontrate
- Çmimi këtyre kostove/artikujve/aktiviteteve duhet te llogaritet dhe inkorporohet ne çmimin e orëve ne tabelën e specifikimit te çmimit.

Pyetja jonë ishte se:

Sipas jush në analizën finaciare keni kërkuar që të paguhen : Pagat neto për punëtorë me te gjitha kontributet dhe tatimet,Pushimetvjetore, ndërrimet e natës, festat shtetërore, Shtesat tjera a duhet të përfëshihen? siq janë vikendet etj?
Lidhur me shujten ju keni vendosur një prag prej 1.75 euro i cili bie ndesh me Marrëveshjen Kolektive bie pasi që ajo cekë:
Neni 54 Kompensimi i shpenzimeve për ushqim gjatë punës 1.Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete. 2.Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës. 3. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim.?

- Në qka e keni bazuar pragun prej 1.75 një shujtë?
- Qka keni nënkuptuar me "shpenzimet tjera" ju lusim specifikoni?

Në përgjigjien tuaj juve keni cekur:

- Te gjitha obligimet per pagesën shtese sipas Ligjjt te Punes dhe akteve te nderlidhranenlgjoreduhet te përfshihen
- Pragu minimal i kostos referente për shujte përcaktuar duke u bazuar ne kompensimin qe punëtorët e KEK marrin per ushqim.Për informim Marrëveshja Kolektive ka skaduar dhe nuk është ne fuqi.
-

Tek shpenzimet tjera duhet deklaruar te gjitha shpenzimet tjerapërtej atyre qe janë kërkuar ne DTe qe janë te domosdoshme për realizmin e kësaj kontrate. Ne këtë pozicion duhet përfshi edhe fitimin e pritur te kompanisë nga kjo kontrate?

Kjo përgjigjëje juaja nxitë pasiguri për kritere të matëshme dhe vlerësim jo të drejtë pasi që neve ka mundësi të mos kalkulojm ndonjë nga shpenzimet tjera? Kërkojm të na sqaroni se a lejohet që OE-së në vend të shujtes të kompenzohen me pagesë prej 2 euro?

Duke u bazur në paqartësit që keni lënë në këtë aktivitet të prokurimit,diskrepancen e krijuar mes kërkesave tuaja dhe buxhetit të planifikuar paqartësin se qka duhet kalkuluar e qka jo, KËRKOJM që të aprovoni kërkesen tonë dhe AP ta këtheni në ri-vlersim dhe rivendosje të kritereve pasi që ka elemente të mëdha për manipulim të ofertave dhe pasiguri për vlerësim të drejtë dhe të duhur.

Konform afatit ligjor neve do të poltësojm me pretendime tjera ankesë....

KRITERET PËR VLERËSIM

-Dosja e Tenderit
-Neni 5 Kalkulimi i afateve kohore
-Analiza Financiare

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në raportin e vlerësimit,komisioni vlerësues ka konstatuar si në vijim:

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "ALPHA PRIVATE SECURITY"SHPK

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Alpha Private Security"Shpk, se AK me rastin e publikimit të dosjes së tenderit tek kërkesat e kapacitetetit teknik dhe profesional nën c) ka përcaktuar " Deshmi se zyrtari ngarkuar për siguri dhe shëndet në pune posedon Certifikatat nga MPMS për dhënien e provimit profesional nga fusha sigurisë dhe shëndetit në punë,sipas ligjit NR. 04 L-161 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË dhe akteve të ndërlidhura nënligjore.Të dëshmohet me kopje të certifikatës, kopje të deklaratës së trustit pensional dhe kontrate pune" që sipas OE ankues kjo kërkesë është e pa bazë dhe është dashur ta zavendsoj me një kontratë duke angazhuar një kompani për mbikqyrje për SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues konsideron që është në kompetence të AK-së të përcaktoj kërkesa me të cilat sigurohet që do të implementoj projektet e caktuara,përshkak se kjo është procedurë komplekse me vlerë të madhe është në të drejtën e AK të vendos kërkesa specifike me qëllim të realizimit të shërbimeve në lëmine e sigurimit dhe shëndetit në punë.
OE ankues në pretendimin e tij nuk ka arsyetuar nëse kjo kërkesë është favorizuese apo diskriminuese apo në kundërshtim me LPP-në, por vetëm ka sugjeruar që të zëvendsohet me një kontratë tjetër që ndërlidhet me shëndetin në punë.

Konsideroj që pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e OE ankues "Alpha Private Security"Shpk, se AK me rastin e publikimit të dosjes së tenderit ka përcaktuar kritere të paqarta,konkretisht tek kërkesa për pagesën e punëtorëve lidhur me zbatmin e Ligjit të punës dhe udhëzimin administrativ të MPMS nr.09/2017 nuk është sqaruar neni 58 i Ligjit të punës se cilat kërkesa duhet të respektohen,eksperti shqyrtues ka këtë mendim

Eksperti shqyrtues sqaron se ky pretendim i OE ankues është trajtuar edhe në ekspertizën nr.749/21, citoj "Në dosje të tenderit lidhur me këtë kërkesë është specifikuar :"Duke marr parasysh rendësin e objekteve që duhet të ruhen si dhe nivelin e stafit dhe motivimit të tyre çështja e pagave të rojeve fizike është e një rëndësie të veçante për autoritetin kontraktues. Paga minimale neto bazë (pa aplikimin e tatimeve, kontributeve, pagesave shtese dhe lejimeve komform Ligjit të Punës ne fuqi), për roje fizike të angazhuar në ketë kontratë duhet të jetë jo me pak se 350 € në muaj. Ky çmim është për ndërrimin e pare. Kontraktori është i obliguar që të respektoj Ligjin e punës, Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2017 dhe të paguaj shtese mbi pagën neto baze për ndërrimin e dyte dhe të tretë dhe festa, shujtën .
Duke iu referuar Ligjit të punës në fuqi dhe UA të ndërlidhura, fondi orëve për një muaj është 176 për një muaj."

Eksperti shqyrtues sqaron se lidhur me këtë pretendim të OE ankues ka pasur një pyetje nga një OE dhe sa i përket pretendimit të OE ankues se cilat nga kërkesat e nenit 56 të Ligjit të punës duhet të respektohen(të listuara më poshtë):
1. Për punën më të gjatë se orari i plotë i punës, si dhe për punë në ditët e festave shtetërore dhe për punën e natës, i punësuari ka të drejtë në pagë shtesë, në pajtim me këtë ligj,Kontratën Kolektive dhe Kontratën e Punës.
2. Të punësuarit i takon paga shtesë në përqindje të pagës bazë, si më poshtë:
2.1. 20 % në orë për kujdestari;
2.2. 30 % në orë për punë gjatë natës;
2.3. 30 % në orë për punë jashtë orarit;
2.4. 50 % në orë për punë gjatë ditëve të festave; dhe
2.5. 50 % përqind në orë për punë gjatë fundjavës.
3. Pagesa shtesë për punë gjatë fundjavës, festave dhe ditëve të lira sipas ligjit e përjashtojnë njëra-tjetrën.

Eksperti shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit AK shumë qartë e ka specifikuar që kontraktori është i obliguar që të respektoj Ligjin e punës, Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2017,që nënkupton që të gjitha kërkesat/detyrimet e nenit 56 dhe neneve tjera të Ligjit të punës 03/L-212 duhet të respektohen.
OE gjatë kalkulimit të analizës financiare duhet të kalkulojnë të gjitha të drejtat/detyrimet që janë të rregullura më Ligjin e punës 03/L-212 dhe Udhëzimin Administrativ te MPMS Nr. 09/2017 .

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin tjetër e OE ankues "Alpha Private Security"Shpk,se AK nuk ka ofruar sqarime të mjaftueshme lidhur me kërkesën për uniforma,eksperti shqyrtues sqaron se edhe ky pretendim është trajtuar në ekpsetizën nr.749/21 citoj "Në dosje të tenderit lidhur me këtë kërkesë është specifikuar" Operatori Ekonomik është i obliguar që punëtoret e angazhuar të pajisen me Uniform unike të punës. Uniformat duhet të u përshtaten standardeve mbi sigurimin fizik te objekteve sipas Ligjit për Sherbimet Private te Sigurisë (Nr. 04/L-004) dhe sipas kërkesës se standardeve nga MPB dhe duhet te përmbajnë :

Nr.	Uniforma dimërore:	Sasia
1	Jakne (xhaket) trashe dimërore me emblema te shtypura te kompanisë	360
2	Xhemper i trashe dimëror me emblema te shtypura te kompanisë	360
3	Këmishë me mëngë te gjata me emblema te shtypura te kompanisë	360
4	Pantallona dimërore	360
5	Këpucet e punës	360

Eksperti shqyrtues sqaron së në dosje të tenderit shumë qartë është specifikuar që OE është i obliguar që punëtoret e angazhuar të pajisen me Uniform unike të punës.Uniformat duhet të u përshtaten standardeve mbi sigurimin fizik të objekteve sipas Ligjit për Sherbimet Private te Sigurisë (Nr. 04/L-004) dhe sipas kërkesës se standardeve nga MPB.
Gjithashtu në një pyetje të një OE lidhur me këtë pretendim AK ka sqaruar se kostot e uniformave janë obligim i OE dhe duhet të llogariten tek shpenzimet tjera.
Sa i përket pretendimit se nuk është specifikuar nëse për uniforma ofrohet çmimi jo normalisht i ulët se a do të eleminohet ajo ofertë,eksperti shqyrtues sqaron se kur ofrohen tender apo pozicione me çmime jo normalisht të ulëta,AK gjatë vlerësimit të tenderëve është i obliguar të zbatoj nenin 61 të LPP-së dhe Rregullën për tenderët jo- normalisht të ulët.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin tjetër të OE ankues se OE duhet te paraqesë analize financiare me shkrim se si ka ardhur deri te çmimi përfundimtar e ku kjo analize duhet të përfshijë se paku:

- Pagat neto për punëtorë me te gjitha kontributet dhe tatimet,
- Pushimet vjetore, ndërrimet e natës, festat shtetërore,
- Shujte te ngrohte (me vlere referente jo me te vogël se 1.75 € për një shujte).
- Vlerën për uniforma verore dhe dimërore sipas specifikacionit ne dosje te tenderit,
- Sigurimi shëndetësor për roje, menaxher te projektit dhe menaxher te zonave me mbulim dhe përfitime minimale te obligueshme sipas ANEKSIT A me poshtë.
- Shpenzimet tjera dhe fitimin e pritur te OE nga kjo kontrate
- Çmimi këtyre kostove/artikujve/aktiviteteve duhet te llogaritet dhe inkorporohet ne çmimin e orëve ne tabelën e specifikimit te çmimit.

Pyetja jonë ishte se:

Sipas jush në analizën finaciare keni kërkuar që të paguhen: Pagat neto për punëtorë me te gjitha kontributet dhe tatimet,Pushimet vjetore, ndërrimet e natës, festat shtetërore,Shtesat tjera a duhet të përfëshihen? siq janë vikendet etj?
Lidhur me shujten ju keni vendosur një prag prej 1.75 euro i cili bie ndesh me Marrëveshjen Kolektive bie pasi që ajo cekë:
Neni 54 Kompensimi i shpenzimeve për ushqim gjatë punës 1.Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës (prej 8 orë), për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy (2) euro, varësisht nga rrethanat dhe mundësitë për rastet konkrete. 2.Aty ku nuk ka shtesa mbi pagën bazë dhe ka mundësi financiare, mund të paguhet kompensimi për ushqim gjatë orarit të punës. 3. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit, kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim pagese (2 euro), të të punësuarve për ushqim.?

- Në qka e keni bazuar pragun prej 1.75 një shujtë?

- Qka keni nënkuptuar me "shpenzimet tjera" ju lusim specifikoni?

Në përgjigjien tuaj juve keni cekur:

- Te gjitha obligimet per pagesën shtese sipas Ligjjt te Punes dhe akteve te nderlidhra nenligjore duhet te përfshihen
- Pragu minimal i kostos referente për shujte përcaktuar duke u bazuar ne kompensimin qe punëtorët e KEK marrin per ushqim.Për informim Marrëveshja Kolektive ka skaduar dhe nuk është ne fuqi.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK ka specifikuar në dosje të tenderit komponentët e analizës financiare që duhet të përfshijnë OE, ndërsa tek kërkesa “Shpenzimet tjera dhe fitimin e pritur të OE nga kjo kontratë”,AK nuk ka dhënë ndonjë sqarim plotësues në përgjigjien e tij lidhur me pyetjen e parashttuar nga OE se çka nënkupton me shpenzime tjera.
Pershkak se në dosje të tenderit është kërkuar që kjo kërkesë të përfshihet në analizë financiare AK është dashur të përcaktoj kërkesa të qarta dhe të matshme me qëllim që OE të kenë qartësi në kalkulimin e ofertave të cilat do të ishin me reale dhe do të ishin në dobi edhe të vetë buxhetit të AK-së, andaj AK duhet të specifikoj qarte se qka nënkupton me shpenzime tjera ose ta heq ketë kërkesë nga dosja e tenderit.

Pretendimi ankimor është i bazuar

Sa i përket pretendimit lidhur me pagat e menaxherëve se a duhet të jene bruto apo neto, eksperti shqyrtues sqaron se në dosje të tenderit është specifikuar që paga minimale për një menaxher duhet të jetë minimum 500 €/muaj, ndërsa në përgjigjen e AK është sqaruar se paga duhet të jetë neto.

Pretendimi ankimor është i pabazuar

Sa i përket pretendimit të OE ankues se AK nuk ka respektuar afatet për dorëzimin e tenderëve duke lënë më pak se 20 ditë afat për dorëzimin e tendereve që është në kundërshtim me LPP-së,eksperti shqyrtues sqaron se afatet e përcaktuara/shkurtuara në këtë procedurë të prokurimit janë në harmoni me nenin 46 të LPP-se,paragrafi 2.1.
Konsideroj që ky aktivitet i prokurimit është ri-tender dhe dosja e tenderit në përgjithësi është e njejte dhe OE janë të njoftuar më dosjen e tenderit,gjithashtui AK ka publikuar formularin B54 për informta shtesë sipas të cilit afati i dorëzimit të tenderëve është zgjatur nga data 21.04.2022 der më 10.25.2022, andaj pretendimi ankimor i OE ankues për shkurtim të afatave për dorëzimin e tenderëve është i pa bazuar.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet pjesërisht si e bazuar** dhe rekomandon autoritetin kontraktues që ta **PLOTËSOJ/KORRIGJOJ** Dosjen e Tenderit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - “KEK”
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues - “ALPHA PRIVATE SECURITY”SHPK